

Data 25.09.2024

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbim**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E TERMAVE TË REFERENCËS DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Tirana Digital Nomad Festival”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** 79952000-2 Shërbime të organizimit të eventeve; 79952100-3 Shërbime të organizimit të eventeve kulturore .

**VLERA E FONDIT LIMIT: 16,454,756**(gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë )lekë pa tvsh, me objekt:“**Tirana Digital Nomad Festival**”, vënë në dispozicion me anë të V.K.B-së Nr. 125 dt 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024”, i ndryshuar.

**Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), si dhe Nenit 42 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:**

*Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar preventivit të artikujve, specifikimeve teknike, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë pasi do e bënte shumë të vështirë për tu menaxhuar.*

*Kjo procedurë shërbimi duhet të kryhet nga një operator ekonomik i cili do të shpallet fitues, pasi lloji i shërbimit për të qenë sa më efikas duhet të jetë i përqëndruar tek një operator ekonomik. Kryerja nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizimin e punës por sidomos e bën shumë më të përshtatshëm monitorimin dhe raportimin e të gjitha proceseve të punës që ky shërbim ka. Ndarja në lote do të sillte konfuzion pasi të gjithë zërat e kërkuar për ofrimin e shërbimit janë procese të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe ndarja e tyre në lote do të sillte crregullim në proces dhe vështirësi në monitorim të shërbimit si dhe kosto shtesë për AK, duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë që ka shërbimi për organizimin e Festivalit të Nomadëve e cila është parashikuar të zhvillohet tek Piramida e Tiranës.*

*Për këtë arsye, është e pamundur që zërat e shërbimeve të ndahen në grupe ose vec e vec secili, pasi do të vështirësonte realizimin e kontratës, rrjedhimisht nga mundësia e lidhjes së kontratës me disa operatorë ekonomikë të ndryshëm, ndaj AK ka vendosur që këtë procedurë ta zhvillojë pa e ndarë në lote.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave të referencës dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar) si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik(i ndryshuar): citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

## **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP(i ndryshuar), nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së parashikuar të kontratës përkatësisht: **16,454,756** (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar), si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pika 3.

**2.2.2** Kopje të certifikuara të balanceve të tre viteve të fundit (2021,2022,2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar), si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar).

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.*

**2.2.3** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR).

*\*\*\* Kriteri 2.2.3 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 9. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP(i ndryshuar), nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.*

*Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

*Kriteri i vendosur është në përputhje me nenin 41, pika 3 të VKM së sipërcituar dhe garanton se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, kanë realizuar kontrata të ngjashme me ente publike apo me sektorin privat dhe i kanë përmbushur detyrimet e parashikuara në kontratë. Vlera jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës, është vlerë e arsyeshme dhe në përputhje me dispozitat ligjore.*

### **2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me:**

a) Standardin ISO 9001 ose ekuivalente (ose e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.*

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar),*

*“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”*

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

*“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”*

### **Kërkesa për Standardin ISO 9001 ose ekuivalente**

*Certifikata e standardit të cilësisë ISO 9001: është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë se kompanive të të gjithë sektorëve dhe të gjithë përmasave. Ky kriter kërkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi të kontratës objekt prokurimi, sipas standardeve ndërkombëtare.*

*Sistemi i menaxhimit të cilësisë, siguron që operatori ekonomik zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij.*

*Nisur nga proceset e punës kritike, rëndësisë së sistemit dhe shërbimeve që ai ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik, proceset e punës së tij, ti bazojë në standarde botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtësi, dhe efikasitet të shërbimeve të ofruara.*

*Për sa më sipër, kërkesa për ISO 9001 (ose ekuivalente) është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar suksesin e kontratës.*

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të ketë një personel teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, konkretisht:

- 3 (tre) Teknikë Audio
- 3 (tre) Teknikë Ndriçimi, LED
- 1 (një) Fotograf dhe 1 (një) Videograf
- 1 (një) Master of Ceremony (Prezantues)
- 1 (një) Kurator Eventi
- 1 (një) Guidë Turistike
- 4 (katër) Performanca Artistike
- 1 (një) DJ
- 1 (një) Teknik Regjie

Për të vërtetuar këtë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë pune e vlefshme për periudhën e zbatimit të Kontratës ose kontratë angazhimi/shërbimi apo çdo marrëveshje tjetër kontraktuale;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B;

*Shënim: Kriteri 2.3.3 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

*Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

*Kërkesa për staf është e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen.*

Numri i përcaktuar për secilin nga teknikat është përlllogaritur, duke marrë në konsideratë proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës dhe është në përpjestim me natyrën, përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe limitet kohore të parashikuara për të përfunduar këtë kontratë.

**Argumentin teknik per personelin teknik si mëposhtë:**

-3 (tre) Teknikë Audio nisur nga natyra e shërbimit që do të realizohet për montimin e skenografisë për Tirana Digital Nomad Festival, është gjykuar e arsyeshme që operatori ekonomik të kontraktojë minimalisht 3 (tre) teknikë audio në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

-3 (tre) Teknikë Ndriçimi, LED nisur nga natyra e shërbimit që do të realizohet për montimin e skenografisë për Tirana Digital Nomad Festival, është gjykuar e arsyeshme që operatori ekonomik të kontraktojë minimalisht 3 (tre) teknikë ndriçimi për të montuar strukturat LED dhe ndricimin për festivalin, në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

-1 (një) Fotograf dhe 1 (një) Videograf nisur nga natyra e shërbimit që do të realizohet për dokumentimin vizual të Tirana Digital Nomad Festival, do të nevojiten 1 (një) fotograf dhe 1 (një) videograf, të cilët do të jenë të pranishëm për 5 (pesë) ditë të plota, në të cilat do të realizojnë regjistrimin dhe dokumentimin e momenteve kyçe të eventeve, përpunimin dhe redaktimin e materialeve vizuale për të siguruar cilësi të lartë dhe sigurimin e një arkive të plotë vizuale të aktiviteteve të zhvilluara.

- 1 (një) Master of Ceremony (Prezantues) nisur nga natyra e shërbimit për prezantimin dhe mirëpritjen përgjatë agjendës së Tirana Digital Nomad Festival, Bashkia Tiranë kërkon një person dinamik dhe me eksperiencë në komunitetin e nomadëve digjitalë për rolin Master of Ceremony. Master of Ceremony do të ketë për detyrë të prezantojë agjendën dhe folësit si dhe të menaxhojë kohën për të siguruar një rrjedhë të pandërprerë dhe të suksesshme të eventit.

- 1 (një) Kurator Eventi nisur nga natyra e shërbimit që do të realizohet për organizimin e festivalit, i cili do të ketë përfaqësi nga komuniteti ndërkombëtar i nomadëve digjitalë, kërkohet që Kuratori i Eventit të jetë pjesë ose të ketë eksperiencë dhe marrëdhënie të vazhdueshme me këtë komunitet në mënyrë që të ndihmojë në organizim, duke kontribuar në krijimin e programit të festivalit. Të kontribuojë me grupin e tij të kontakteve dhe të ndihmojë grupin e punës i cili do të menaxhojë eventin gjatë periudhës së organizimit dhe gjatë ditëve të festivalit.

- 1 (një) Guidë Turistike nisur nga natyra e shërbimit që do të realizohet për organizimin e festivalit, i cili do të ketë përfaqësi nga komuniteti ndërkombëtar i nomadëve digjitalë dhe jo vetëm, është parashikuar e nevojshme përfshirja e 1 (një) guide turistike, i cili duhet të jetë njohës i mirë i qytetit të Tiranës dhe gjuhës angleze në mënyrë që të kemi një prezantim dinjitoz. Guida do të ofrojë ture në qytet përgjatë ditëve të eventit. Gjithashtu, prezanton atraksionet dhe ndan informacion të vlefshëm për kulturën dhe historinë e qytetit tonë.

-4 (katër) Performanca Artistike nisur nga natyra e këtij organizimi, është gjykuar e nevojshme të përfshihet në program edhe pjesëmarrja e 4 (katër) performancave artistikë të cilat do të ofrojnë një atmosferë argëtuese për të pranishmit duke e mbajtur audiencën të motivuar dhe me dinamizëm.

- 1 (një) DJ Nisur nga natyra e këtij organizimi, është gjykuar e nevojshme të përfshihet në program edhe një DJ i cili do të realizojë performanca përgjatë mbrëmjeve.

- 1 (një) Teknik Regjie për të siguruar mbarëvajtjen dhe suksesin e festivalit, është gjykuar e nevojshme që operatori ekonomik të ketë të kontraktojë 1 (një) Teknik Regjie për të ndihmuar në menaxhimin dhe vendosjen e videove prezantuese të eventet gjatë ditëve të ndryshme gjatë festivalit. Ky person duhet të jetë i gatshëm për të përmbushur kërkesat e stafit të Bashkisë dhe folësve të eventit.

Referuar termave të referencës, preventivit, natyrës dhe objektit të saj, si dhe shërbimeve të kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor, shfaqet e nevojshme zotërimi i stafit me kompetencat e mësipërme.

*Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.*

#### **2.3.4** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deklaratë nga administratori i shoqërisë:

1. se marrin përsipër transportimin, montimin, mbarëvajtjen teknike, çmontimin dhe largimin e pajisjeve pas përfundimit të çdo aktiviteti, të gjitha pajisjet teknike të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit në vendin përkatës sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
2. se disponojnë pajisjet teknike për realizimin e kontrates duke përcaktuar në deklaratë llojin dhe specifikimet teknike për çdo paisje të kërkuar referuar preventivit.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe të nenit 41, pika 4/ç të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar). Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

**Shënim:** OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

#### **Argumentim i termave të referencës:**

*Termet e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën me objekt “**Tirana Digital Nomad Festival**”, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Objektivi kryesor i kësaj kontratë synon që organizimi I ketij festivali te jete nje dritare ku perqafimi I punes fleksibel dhe qendrueshme shfaqet si nje realitet i arritshem per te gjithë. Duke e vendosur Tiranen si nje pike takimi kyce per komunitetin global te nomadeve dixhitale, ne kerkojme te terheqim dhe te inkurajojme talentin dhe inovacionin qe rrjedh nga cdo cep i botes. Ky event do te sherbeje si nje platforme e jashtezakonshme per te ndertuar dhe zgjeruar rrjetet nderkombetare, duke u mundesuar profesionisteve, sipermarresve dhe krijuesve te ndajne ide, te zhvillojne bashkepunime te reja dhe te bejne shkembime kulturore dhe profesionale qe do te ndihmojne ne formesimin e ardhjes se punes ne boten digjitale. Të promovojë një kulturë të punës fleksibël dhe të qëndrueshme që lejon individët të përfitojnë nga teknologjia për të jetuar dhe punuar në mënyrë më të lirë dhe të pavarur. Te vendose Tiranen ne harten globale si nje qender te rendesishme per nomadet dixhitale, duke terhequr talent dhe inovacion. Te nxise ndertimin e rrjeteve nderkombetare midis profesionisteve, sipermarresve dhe krijuesve nepermjet bashkepunimeve dhe shkembimeve kulturore dhe profesionale.

Termet e referencës të këtij shërbimi, janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe OE të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “**Tirana Digital Nomad Festival**”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

#### **Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

*Dokumentat e tenderit  
Termet e referencës*

#### **NJËSIA E PROKURIMIT**